

Sejfullah Sejfullahu lindi me 16.12.1970, në fshatin Krushë e Madhe.

Shkollën fillore, dhe dy vite gjimnaz i kreu në fshatin e tij të lindjes, kurse dy vite të tjera në Gjimnazin e Prizrenit, për të vazhduar studimet në SHLP “ Xhevdet Doda” në Prizren.

Sejfullahu ishte vazhdimisht aktivist fillimisht i fshatit, e më vonë edhe më gjerë.

Ishte një nga organizatorët, por edhe pjesmarrës i demonstratave të vitit 1990, në Krushe dhe fshatra për rreth. Ishte përherë, pothuaj çdo dit pranë të madhit Profesor Ukshin Hoti, deri në burgosjen tij.

Sejfullahu ishte pjesë e Ushtrisë së Lavdishme Çlirimtare të Kosovës.

Me fillimin e bombardimeve të NATO-s, Sejfullahun e gjenë duke ndihmuar popullatën civile që të strehoeshin e mbroheshin nga sulmet dhe masakrat serbe, por me natën e 2 prillit, gjatë granatimeve serbe, plagoset rëndë në fshatin Nagavc, dhe mjekohet në spitalin ushtarak të Tiranës. Sejfullahu, që nga mbarimi luftës është angazhuar për gjetjen dhe identifikimin e shumë të pagjeturve Krushjanë, përfshirë edhe profesor Ukshin Hotin.

Krahas këtyre angazhimeve, Sejfullahu ka më shumë se 25 vite që udhëheq edhe ansamblin “Bajram Curri”, anëtar i së cilës është që nga mosha 13 vjeqare.

Sejfullahu nga viti 2021 është zgjedhur asambleist I PDK.

Sejfullahu është i martuar me znj. Bukurije dhe kan katër fëmijë: Drenushën, Eleanorën, Drenin dhe Damonin.